POP 5 Njoftime me shumë shikues në javën e kaluar

1 Carlo Ancelotti: Pari po qendrojnë brazilianët nga situatës së Neymar-it

2 Kosovarët e lënë Bosnjën e Ligës, ish-"Yeesh Sullga"

3 Si qëndroi pë kaloi vite i ka ati Bujar Lumos Leka, personi që prenoi Kryeministrin e Kosovës

4 Jugoslavët nuqë nuqa na Shqipërë

5 Disfi raporti i KE shenjon 11 mapsa "kuq" e disapotës kaq i shqetësuar janë kosovarët me Autoritetin financiarë e partive

6 Vllaznia hedh syrë nga ish-futbolisti i Kombëtares

7 Mero Baze: Gërguroni prostitutën M Fatmir Mediut

Kronika

Breshëri plumbash hotelit të ish-shoferit të Arjan Ndojës në Fushë-Krujë! Autorët e maskuar qëlluan nga kodra me kallash! Pistat e hetimit (VIDEO)

Hotel dhe lokali i ish-shoferit të Arjan Ndojës, Mond Voga, në Krastë të Krujës u qëllua me breshëri plumbash pas mesnate. Për fat të mirë askush nuk u lëndua, por plumbat depërtuan deri në banak. Autorët dyshohet se janë 2 dhe dolën e u larguan nga pylli. Hetuesit dyshojnë për ndonjë konflikt pronësie, por nuk përjashtohen pista të tjera.

■ Autorët u larguan në këmbë! Pistë hetimi, konflikte pronësie

HOROSKOPI

RAPORTOI! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
20 Qershor, 09:41 | **Përditësimi: 20 Qershor, 14:55**

Share

FUSHË-KRUJË- Lokali dhe hoteli në pronësi të Mond Vogës, ish-shofer i deputetit të zgjedhur, Arjan Ndojës, u qëllua me breshëri plumbash rreth orës 01:10 pas mesnate në Krastë të Krujës. Si pasojë e të shtëneve, për fat të mirë nuk ka të dëmtuar në njerëz, por dëmet materiale janë të konsiderueshme.

Shenjat e plumbave thyen xhamat e lokalit, duke depërtuar deri në hapësirën e brendshme. Në momentin e agresionit, në hotel ishin vetëm familja e Mond Vogës, e cila jeton prej vitesh aty, ndërsa nuk kishte turistë apo të akomoduar të tjerë. Në pamjet që sjell Report Tv, shenjat e plumbave dallohen gjithandej nëpër biznes, nga fasada, në banak e tavolil duhani.

Autorët, të cilët dyshohet se ishin të paktën 2, dolën nga një sipërfaqe pyjore në afërsi dhe qëlluan nga kodra përballë hotelit dhe qëlluan me plumba kallashnikovi. Në vendin e ngjarjes policia gjeti 15 gëzhoja. Me kapuç, autorët u larguan sërish në këmbë përmes pyllit, dhe nuk përjashtohet mundësia që të jenë ndihmuar nga persona të tjerë për t'u arratisur.

LEXO EDHE:
Tentuan të kalonin kufirin me dokumente të falsifikuara drejt Britanisë, bien në prangat e policisë dy turq në Rinas

Para hetuesve, Mond Voga qëndroi i rezervuar kur u pyet mbi dyshimet se kush mund të jenë autorët e mundshëm. Ndërkohë, burime pranë grupit hetimor bëjnë me dije se hetimet janë shtrirë në disa pista, për shkak të konflikteve të shumta që pronari ka pasur në të shkuarën. Një ndër pistat kryesore që po shqyrtohet lidhet me një konflikt për çështje pronësie, megjithatë nuk jepen ende detaje të plota.

49-vjeçari Voga, vite më parë, shërbeu si shofer i ish-prokurorit Ndoja, i cili në 2019-ën i shpëtoi një atentati, ndërsa u shkarkua nga sistemi i drejtësisë për lidhje të shumëfishta me krimin por edhe për pasuri të pajustifikuar. Edhe në vitin 2017, Mond Vogës iu vendos eksploziv në lokal. Ai është një person me precedent të mëparshëm kriminal pasi dhunoi avokatin Ilia Ilia në 2018-ën. Po ashtu, Voga është arrestuar në janar 2020 në Tiranë për armëmbajtje pa leje, pasi udhëtonte me një mjet të blinduar dhe me fenelina. Deri në shtator 2019 ka qenë inspektor mjedisi në Durrës, ndërsa para 2018-ës drejtor i ALUIZNI-të Fushë Krujë. Para disa vitesh, vëllait të tij çë punon efektiv policie në Tiranë, i dogjën makinën dhe i lanë dy granata.



Mondi Voga dhe Arjan Ndoja

Raportuan për Report Tv gazetarët Julian Shota dhe Sokol Dema

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 11:31

Fushë-Krujë/ Qëlluan me kallash lokalin e ish-shoferit të Arjan Ndojës, burime: Autorët u larguan në këmbë! Pistë hetimi, konflikte pronësie

Mondi Voga, ish-shoferi i deputetit të zgjedhur, Arjan Nodja, kallëzoi në Policinë e Tiranës se u qëllua me armë në drejtim të lokalit të tij në fshatin Krastë.

Teksa është marrë në pyetje nga bluté Voga ka qëndruar i rezervuar duke mos dhënë detaje mbi autorët e mundshëm.

Ndërkohë, burime pranë grupit hetimor bëjnë me dije se hetimet janë shtrirë në disa pista, për shkak të konflikteve të shumta që pronari ka pasur në të shkuarën.

Një ndër pistat kryesore që po shqyrtohet lidhet me një konflikt për çështje pronësie, megjithatë nuk jepen ende detaje të plota.

Autorët dyshohet se kanë dalë nga zona e pyllëzuar dhe kanë qëlluar në drejtim të lokalit, ndërsa mbanin kapuçë në kokë për të fshehur identitetin.

Pas atentatit, ata janë larguar në këmbë në drejtim të pyllit, por nuk përjashtohet mundësia që më pas të jenë ndihmuar nga persona të tjerë për t'u larguar me automjet.

Hetuesit po analizojnë pamjet e kamerave të sigurisë të bizneseve përreth, me qëllim identifikimin e autorëve

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:19

Plumba kudo, edhe tavullave të duhanit! Mund të kishte pasur tragjedi, edhe djali i pronarit i shpëtoi predhave, po flinte nga krahu i hotelit që u sulmua (VIDEO)

Ndërsa Policia e Durrësit dhe Krujës, bashkë me Prokurorinë vendore po kryejnë veprimet procedurisë pas sulmit me breshëri plumbash ndaj biznesit lokal-hotel në Fushë-Krujë, zbardhen detaje të rëndа nga dinamika dhe rrethanat.

Plumbat nuk kanë kursyer as tavullat e duhanit nëpër tavolina, gjë që tregon se mund të kishim pasur një tragjedi të vërtetë nëse lokali do ishte i frekuentuar në ato momente.

Gjithashtu edhe fakti se në krahun nga ku predhat depërtuan të gjitha katet e objektit, flinte edhe djali i pronarit të biznesit, ish-shoferi i prokurorit Ndoja.

Në një nga dhomat me parnje nga ruga po flinte djali i pronarit, ndërsa pjesa tjetër e familjes flenë nga ana mbrapa e hotelit. Është goditur me shumë plumba si kati i parë, ashtu dhe kati i dytë.

A.G/Shqiptarja.com

Share

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Tiranë fushë krujë arjan ndoja he shtëna me armë Mondi Voga

Komento

Komente

Pallashi: 20/06/2025 11:59

Opsi si ka mundesi qe kush mi me ate ndojen jan ne mezik e ndorjenr u del emri te shyfta?

Pëngëgju

Ndalohet riprodhimi i kësaj shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SONDAZH

20 Qershor, 11:01

Sondazhi i ditës:
Çmimet më të larta se në BE, a mendoni se duhet të ndërhyjë qeveria?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Fushë-Krujë/ Zbulohen një rast i murtajës së bagëtisë në Sukth-Vendas! Infektohet tufa prej 100 delesh
21 Qershor, 16:57

Tiranë/ Abuzoi me 11-vjeçaren, Apeli dënon të riun me 20 vite burg
21 Qershor, 15:04

FOTOT/ 'Dy zemra' për PS, mënyrat e pazakonta të votimit në Tiranë
21 Qershor, 14:34

Veliaj: Mbi 75 bllokë banimi të Tiranës janë transformuar
21 Qershor, 14:05

Tiranë/ Dhunoi ish-gruan dhe goditi me grushte bashkëjetuesin e kunatin e saj, arrestohet 39-vjeçari! Shpallet në kërkim kushëriri i tij
21 Qershor, 13:12

3 vëllezërit kërcënojnë me armë të riun në Tiranë, 2 në pranga, njëri në kërkim
21 Qershor, 13:03

'Mbushësh' ish-Bllokun me drogë, lihen në burg 22 anëtarët e grupit, lirohet një grua! Report Tv siguron FOTOT e 'kokave'

Keti Banushi

21 Qershor, 11:55

Policia zbulon 'exchange'-in e fajdesve në Tiranë, në hetim pronarja 72-vjeçare! Sekuestrohen 500 mijë euro
21 Qershor, 10:18

VIDEO/ 'Asnjë lëvizje', 5 të rinjtë kapen duke trafikuar 5 kg kanabis në Vallas, tentojnë t'i ikin policisë me makinë
21 Qershor, 09:40

Mbyllet dita e katërt e rinumërimit për Tiranën, hapen 437 kutiti PD i zbriten 207 vota që s'i takonin, PS 177! Edhe Mundësia 8 vota më pak
21 Qershor, 07:53

Nis rikonstruksioni i Spitalit Universitar të Traumës, Koçiu-Vengu: Investim që e shndërron në një godinë moderne
20 Qershor, 18:08

Forumi Euro-Mesdhetar në Tiranë, gati strategjia e re për të ardhmen e rajonit

Blerina Goce

20 Qershor, 17:16

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje